

Platforma për të Drejtat e Njeriut

Constitutional Articles: Mbrojtja e Pronës

1. E drejta e pronës është e garantuar. 2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik. 3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë ekspropriimin e pronës nëse ky ekspropriim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave ekspropriohehet. 4. Kontestet që lindin nga akti i Republikës së Kosovës ose autoritetit publik të Republikës së Kosovës për të cilat pretendohet se përbëjnë ekspropriimin, do të zgjidhen nga gjykata kompetente. 5. Prona intelektuale mbrohet me ligj.

Constitutional Paragraph: Neni 46 para. 1

1. E drejta e pronës është e garantuar.

Instrumentet ndërkombëtare

KEDNJ

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj

DUDNJ

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut

Ligjet

LT

Ligji për trashëgiminë Nr. 2004/26 dhe Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 2004/26 Trashëgiminë në Kosovë Nr. 06/L-008 - 2018

Nenet

Prot. 1 neni 1

Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë e tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare. Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk çenojnë të drejtën e Shteteve për të zbatuar ligje, që ato i çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjjobave të tjera

Neni 17 para 1

Secili ka të drejtë të ketë pasuri, vetë dhe në bashkësi me të tjerët.

Nenet

2

Mund të trashëgohen sendet dhe të drejtat të cilat i përkasin individëve

Ligjet**Nenet**

438

LMD

Ligji për maredhënjet e detyrimeve Nr. 04/L-077

1. Me kontratën e shitjes detyrohet shitësi që sendin të cilin e shet t'ia dorëzojë blerësit dhe t'ia kalojë të drejtën e pronësisë, ndërsa blerësi detyrohet që shitësit t'ia paguajë çmimin dhe ta pranojë sendin. 2. Shitësi i ndonjë të drejte tjetër detyrohet se blerësit do t'ia kalojë të drejtën e shitur, ndërsa kur ushtrimi i asaj të drejte kërkon posedimin e sendit, t'ia dorëzojë edhe sendin.

LPDS

LIGJI NR.03/L-154 PËR PRONËSINË DHE TË DREJTAT TJERA SENDORE

Neni 2

1. Çdo person mund të fitojë të drejta sendore, përveç nëse është paraparë ndryshe me ligj. 2. Titullari i një të drejte sendore mund të paraqesë këtë të drejtë kundrejt cilitdo person, përveç nëse me ligj parashihet ndryshe.

Neni 75**LSHT**

LIGJI NR. 06/L-016 PËR SHOQËRITË TREGTARE

Natyra e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar dhe e Aksionit 1. Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar është person juridik e cila është juridikisht e ndarë nga aksionarët. Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar është vetvetiu bartëse e të drejtave dhe obligimeve. 2. Aksionet në Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar janë njësitë në bazë të të cilave bëhet ndarja e pronësisë në Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar. 3. Një aksion në Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar është pronë personale e aksionarit dhe mund të bartet pjesërisht ose në tërësi, varësisht nga kufizimet e parapara në këtë ligj dhe kufizimet e tjera të përcaktuara në Statut. 4. Në Statutin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar mund, por nuk është e detyrueshme, të parashihet që aksionet të dëshmohen përmes certifikatave të lëshuara nga Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar.

Neni 1**LTPP**

LIGJI Nr. 06/L-005 PËR TATIMIN NË PRONËN E PALUAJTSHME

Ky Ligj vendos tatimin mbi pronën e paluajtshme dhe përcakton rregullat dhe procedurat themelore për administrimin e tatimit në pronën e paluajtshme nga komunat dhe Ministria e Financave.

5.3**LSNSK**

LIGJI Nr. 2003 / 15 PËR SKEMËN E NDIHMËS SOCIALE NË KOSOVË

Të mirat materiale të llogaritshme janë sendet me vlerë që përfshijnë, por nuk përkufizohen vetëm në : pagesat e përgjithshme nga sistemi i Pensioneve Individuale të Kursimit që u jepen pjesëmarrësve ose përfituesve -siç parashihet në Rregulloren 2001/35, pagesa të tjera të përgjithshme, bizneset private apo familjare, prona, disa lloje të caktuara të pasurisë së patundshme, toka, dhe automjetet funksionale që mund të krijojnë të ardhura. Udhëzimi do t'i saktësojë llojet e të mirave materiale të llogaritshme dhe të pallogaritshme dhe principet e vlerësimit të të mirave materiale Në muajin në të cilin merren pagesat e përgjithshme, ato do të trajtohen si të hyra të llogaritshme. Për muajt vijues këto pagesa të përgjithshme do të trajtohen si të mira materiale të llogaritshme.

decisionTitle***decisionDescription***

SPORRONG
AND
LÖNNROTH v.
SWEDEN (Application no. 7151/75; [7152/75](#))
(Përfshirja e eksproprijimit afatgjatë të lejeve të pronësisë, resp

Papamichalopoulos
v Greece (Application no. [14556/89](#))
Në çështjen Papamichalopoulos kundër Greqisë, aplikantëve ju ishte

Belvedere
Alberghiera
kundër Italisë Në rastin Belvedere Alberghiera kundër Italisë (Aplikimi nr. 31524/96), toka e kompanisë së aplika

Broniowski v.
Poland Aktgjykimi Broniowski (Aplikacioni nr. [31443/96](#)
) kishte të bënte me dështimin e pretenduar të autoriteteve polake

Kozac?o?lu v.
Turkey Kozac?o?lu v. Turkey [GC], no. 2334/03, § 63, 19 February 2009: Gjykata ka sqaruar se [shqetësim

Tre Traktörer AB
v. Sweden, 7 July Tre Traktörer AB v. Sweden, 7 July 1989: Aplikantit iu hoq një licencë e alkoolit për një restorant n

Grudi? kundër
Serbisë Në rastin *Grudi? kundër Serbisë*, Aplikimi Nr. 31925/08 (2012), Republika e Serbisë papritmas ua n